

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA I FTUAR NË PANELIN MBI ÇRRËNJOSJEN E KORRUPSIONIT PËRMES POLITIKAVE TË MIRËQEVERISJES DHE REFORMËS NË DREJTËSI

LEXO PËR MË SHUMË



Si Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit të Republikës së Shqipërisë, institucionit që udhëheq të gjithë politikat qeveritare për të çrrënjosur korrupsionin në administratën publike, Manja theksoi faktin se investimi më i madh i qeverisë shqiptare në fushën e shtetit të së drejtës është lufta kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet reformës në drejtësi dhe në administratën publike nëpërmjet mekanizmit të Drejtorisë Antikorrupsion dhe digjitalizimit të shërbimeve publike ku Shqipëria është vendi lider në rajon me 1277 shërbime që ofron online për qytetarët e saj. Në Forumin për Dialog u dha mundësia, jo vetëm për të folur mbi përvojat e Drejtorisë Antikorrupsion, por mbi të gjitha për të gjetur zgjidhje të reja për probleme të përbashkëta të rajonit për të forcuar qeverisjen e mirë dhe transparencën në vendimarrje!

TAKIM ME ZNJ. HELGA MARIA SCHMID, SEKRETAREN E PËRGJITHSHME TË OSBE

LEXO PËR MË SHUMË

Manja e falenderoi znj. Schmid për mbështetjen e vazhdueshme që zyra e OSBE në Tiranë ka dhënë për zbatimin e reformës në drejtësi dhe fuqizimin e kapaciteteve tona njerëzore në policinë e burgjeve. Në këtë takim u ra dakord për të parë mundësi të reja bashkëpunimi në luftën kundër korrupsionit me fokus gender equality, të miturit në konflikt me ligjin dhe thellimin e mbështetjes me ekspertizë sipas fushave prioritare që ka Ministria e Drejtësisë dhe qeveria shqiptare në drejtim të transparencës dhe mirëqeverisjes! OSBE mbetet partner i rëndësishëm dhe i besueshëm në reformat tona të brendshme, por dhe në kuadrin e negociatave me BE.



TAKIM DYPALËSH I MINISTRIT MANJA ME MANUEL SARRAZIN, TË DËRGUARIN E POSAÇËM TË GJERMANISË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

LEXO PËR MË SHUMË



Gjermania mbetet furnizuesi kryesor i paqes në rajonin tonë, nëpërmjet mbështetjes së reformave që forcojnë shtetin e së drejtës dhe sundimin e ligjit. Përveç mbështetjes së pakursyer për zbatimin e reformës në drejtësi, Gjermania është e gatshme të suportojë Shqipërinë dhe në procesin për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së, nëpërmjet ekspertizës së duhur, gjë e cila do të lehtësojë rrugën e Shqipërisë drejt BE-së. Gjermania mbetet mik i çmuar i Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe të rrugës së saj europiane.

TAKIM ME NDIHMËS SEKRETAREN E PËRGJITHSHME DHE DREJTORESHËN PËR BYRONË RAJONALE PËR EVROPËN DHE KOMONUELTHIN E SHTETEVE TË PAVARURA TE UNDP, ZNJ. IVANA ŽIVKOVIĆ


LEXO PËR MË SHUMË

Ndihma juridike falas për kategoritë në nevojë, si një nga elementët e rëndësishëm të reformës në drejtësi, ka patur mbështetjenn e vazhdueshme të UNDP në Tiranë. Ministria e Drejtësisë ka një bashkëpunim të shkëlqyer me zyrën e UNDP në Tiranë, dhe me znj.Živković u diskutua mundësinë që ky model i sukseshëm i Shqipërisë sa i takon ndihmës juridike falas të transmetohet edhe në vendet e Ballkanit.



MINISTRI MANJA NË PARLAMENTIN E LANDIT TË BAVARISË, TAKON ZV.PRESIDENTIN Z.KARL FRELLER

LEXO PËR MË SHUMË



Ministri Manja në Parlamentin e Landit të Bavarisë, takon Zv.Presidentin z.Karl Freller, një mik i vjetër i Shqipërisë dhe i shqiptarëve! Z.Freller në fillimet e karrierës së tij politike, për rreth 6 vjet ka punuar afër me Franz Josef Strauss, një mik i çmuar i popullit shqiptar; dhe dashurinë për Shqipërinë dhe shqiptarët e ka të trashëguar që në kohën kur Shqipëria ishte akoma një vend i mbyllur. E ka vizituar Tiranën në vitin 1993 dhe tani si zv.Kryetar dhe si deputeti me më shumë përvojë në Parlamentin e Bavarisë do të jetë një avokat i shkëlqyer i promovimit dhe mbështetjes që Bavaria do t'i japë Shqipërisë.

MANJA U TAKUA NË MINISTRINË E DREJTËSISË SË LANDIT TË BAVARISË ME MINISTRIN Z. GEORG EISENREICH

LEXO PËR MË SHUMË

Mes homologëve u akordësua një agjendë konkrete pune dhe bashkëpunimi për zbatimin e reformës në drejtësi, por edhe në nivel ekspertize për përafrimin e legjislacionit të Shqipërisë me atë të BE edhe në nivel të kontributit të qeverisë federale, digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, si dhe projekte të tjera që do të identifikohen nga të dy palët. U ra dakord për të caktuar një person kontakti në të dy ministrinë, për të ndjekur agjendën e përbashkët të bashkëpunimit. Rinovimi i një marrëdhënie të hershme me Landin e Bavarisë na afron më shpejt me BE!



TAKIM PUNE ME DREJTORIN E POLITIKAVE Z.MICHAEL HINTERDOBLER

LEXO PËR MË SHUMË



Një takim pune mes Ministrit Manja me drejtorin e Politikave z.Michael Hinterdobler, që po ndjek agjendën e bashkëpunimit dy palësh mes qeverisë shqiptare dhe qeverisë së Landit të Bavarisë, të dakordësuar mes dy Kryeministrave në shkurt të vitit 2023. Bashkëpunimi mes dy qeverive do shtrihet në fushën e drejtësisë, sigurisë, administratës publike, ekonomisë, bujqësisë dhe turizmit! Sot biseduam për drejtësinë! Rinovimi i një miqësie që filloi me mikun e çmuar të Shqipërisë Franz Josef Strauss, është baza e marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy qeverive.

MINISTRI MANJA PRET NË MINISTRINË E DREJTËSISË, Z.GIUSEPPE BUSIA, DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË “ANAC” AGJENCISË KOMBËTARE KUNDËRKORRUPSIONIT TË SHTETIT ITALIAN, SË BASHKU ME AMBASADORIN E ITALISË NË SHQIPËRI, Z.FABRIZIO BUCCI

LEXO PËR MË SHUMË



Ministri Manja pret në Ministrinë e Drejtësisë, z.Giuseppe Busia, Drejtorin e Përgjithshëm të “ANAC” Agjencisë Kombëtare Kundërkorrupsionit të Shtetit Italian, së bashku me Ambasadorin e Italisë në Shqipëri, z.Fabrizio Bucci. Në këtë takim u dakordësua mbi rritjen e bashkëpunimit dhe intensifikimin e marrëdhënieve konkrete midis dy institucioneve Antikorrupsion në vendet tona. Fokus i diskutimit u përqëndrua edhe në gjetjen e mekanizmave për parandalimin e korrupsionit nëpërmjet edukimit ligjor tek gjenerata e re në shkolla dhe universitete, si dhe në konkretizimin e bashkëpunimit nëpërmjet marrëveshjes dypalëshe.

MANJA MIRËPRET NË MINISTRINË E DREJTËSISË, Z. CHRISTOPHE STRAUDD SHEF I INSPEKTORIATIT FRANCEZ TË DREJTËSISË

LEXO PËR MË SHUMË

Në këtë takim u nda qëndrimi i përbashkët për rolin e rëndësishëm që kanë Inspektoriatit Francez i Drejtësisë dhe ILD në Shqipëri, si garantë kushtetues të llogaridhënies së sistemit të drejtësisë në dy vendet tona respektive. Inspektoriatit i Lartë i Drejtësisë nën drejtimin e z.Metani, me rezultatet e prekshme të punës si në aspektin e hetimeve disiplinore dhe në atë të rekomandimeve në kuadrin rregullator, e kthyen ILD në një institucion të besueshëm për publikun shqiptar! Manja garantoj atë që Ministria e Drejtësisë do të ofrojë gjithë mbështetjen e duhur për ILD sipas ligjit, sepse për Shqipërinë një sistem drejtësie i pavarur, i aftë dhe i ndershëm është themeli i demokracisë dhe lirisë së çdo qytetari!



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministria_drejtisesise
ulsimanja



@manja_ulsi